



ARRU/UTSH-10/04/2018

29. 12. 2017

Në pajtim me autoritetin e dhënë me nenin 19., paragrafi 1 të *Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit*, të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016, datë 14. 01. 2016 ("Ligji"), dhe konform nenit 15 të Rregullores ARRU Nr. 07/2016 për Përcaktimin e tarifave të shërbimit të ujit në Kosovë, datë 23 Shtatori 2016.

Duke u bazuar në të dhënat e aplikacionit për Tarifa Shërbimi të dorëzuara nga KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë për procesin tarifor 2018-2020.

Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit (ARRU) lëshon këtë:

URDHËRESË PËR TARIFA SHËRBIMI

TARIFAT E SHËRBIMIT TË UJËSJELLËSIT DHE UJËRAVE TË NDOTURA PËR KRU "MITROVICA" Sh. A. MITROVICË, PËR PERIUdhËN 1 JANAR – 31 DHJETOR 2018 NGA PROCESI TARIFOR 2018-2020

1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit (UTSH), përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që u atribuohen Rregullores 07/2016.

2. Zbatueshmëria

Kjo Urdhëresë e Tarifave të Shërbimit është e zbatueshme dhe e detyrueshme për KRU "Mitrovica" sh. a., me rastin e faturimit të Shërbimeve të Ujësjiellësit dhe Ujërave të Ndotura që u ofron konsumatorëve të vet në tërë zonën e saj të shërbimit.

ARRU mund t'i bëjë korrigjimet e jashtëzakonshme të tarifave të shërbimit në bazë të kërkesës së KRU "Mitrovica" sh. a., në pajtim me nenin 16 dhe 17 të Rregullores 07/2016.

3. Përbajtja e shtojcave të UTSH-së

Kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit i janë bashkangjitur;

3.1 *Shtojca Nr. 1 e cila përmban:*

Pika 1. Lista e Tarifave të Shërbimit të aplikueshme për vitin 2018

nënpika 3.2. sqarimet përkatëse,

Pika 2. Tarifat për shpenzimet e kycjes në rrjetin e shërbimeve të ujit

Pika 3. Tarifat për shërbimet tjera

Tarifat e përcaktuara në këtë UTSH janë pa TVSH.

4. Afati

Tarifat e përcaktuara me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit do të jenë të zbatueshme nga: 1 Janari 2018 gjer me 31 Dhjetor 2018.

5. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifave të Shërbimit

5.1 KRU "Mitrovica" sh. a. duhet të shpërndajë Listën e Tarifave të Shërbimit të aprovuara me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit, tek secili Konsumator në momentin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose së paku një herë në fillim të aplikimit të saj t'i bashkëngjis të njëjtën faturës me të cilën faturohen konsumatorët.

5.2 Lista e Tarifave për Shërbime e aprovuar nga ARRU nën këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit duhet të publikohet nga KRU "Mitrovica" sh. a., së paku në njërën prej gazetave ditore me tirazh gjithë përfshirës në tërë Kosovën, brenda shtatë (7) Ditëve të Punës, pas shpalljes dhe publikimit të saj nga ARRU në portalin e internetit të vet; www.arru-rks.org.

6. Apelet

KRU "Mitrovica" sh. a. ka të drejtë të apelojë këtë urdhëresë ose pjesë të saja brenda një muaji, nga data e publikimit, tek Komisioni Shqyrtues i themeluar konform nenit 41, Komisioni Shqyrtues, Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016.

Gjuhët Zyrtare të Urdhëresës për Tarifa Shërbimi

Kjo Urdhëresë për Tarifa të Shërbimit publikohet në tri (3) gjuhë, dy nga të cilat janë zyrtare që përdoren në Kosovë dhe në Gjuhën Angleze.

Në rast mospërputhje në mes të versioneve të UTSH-ës, do të mbizotërojë versioni i shkruar në gjuhën Shqipe.



Raif Preteni
Drejtor i ARRU

SHTOJCA 1: LISTA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT

1. Tarifat Fikse dhe Tarifat Volumetrike për Shërbimet e Ujësjetës dhe ujërave të Ndotura

Kategoria e Konsumatorëve	Tarifa Fikse (EURO/muaj)	Tarifa Volumetrike për Shërbime të Ujësjetës (EURO/m ³)	Tarifa Volumetrike për Shërbime Ujërave të ndotura (EURO/m ³)
1. TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN 2018 (1 JANAR 2018 – 31 DHJETOR 2018)			
Shtëpiak	1.0	0.36	0.09
Institucional dhe Industrial/Komercial	2.0	0.72	0.19
2. TARIFAT PËR VITIN 2019 PA INFLACION (1 JANAR 2019 – 31 DHJETOR 2019)			
Shtëpiak	1.0	0.3483	0.0870
Institucional dhe Industrial/Komercial	2.0	0.6270	0.1913
2.1 TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN 2019 TË PËRSHTATURA ME INFLACION (1 JANAR 2019 – 31 DHJETOR 2019)			
Shtëpiak	1.0		
Institucional dhe Industrial/Komercial	2.0		
3. TARIFAT PËR VITIN 2020 PA INFLACION (1 JANAR 2020 – 31 DHJETOR 2020)			
Shtëpiak	1.0	0.3409	0.0870
Institucional dhe Industrial/Komercial	2.0	0.5454	0.1913
3.1 TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN 2020 TË PËRSHTATURA ME INFLACION (1 JANAR 2020 – 31 DHJETOR 2020)			
Shtëpiak	1.0		
Institucional dhe Industrial/Komercial	2.0		

2. Tarifat për shpenzimet e kyçje s në rrjetin e shërbimeve të ujit

Afati i Aplikueshmërisë: 1 Janar 2018 – 31 Dhjetor 2018

2.1. Tarifa Administrative për Kyçje në Shërbime*	Diametri i gypit të kyçjes/ujëmatësi	Tarifa për kyçje në shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura (EURO)
Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve (*) –Tarifa për administrim është e pakthyeshme dhe nënkuptojmë të drejtën e konsumatorit për tu kyç në rrjetin e shërbimeve të ujit dhe mbajtjen e tij në regjistrin e konsumatorëve aktiv për çështje të ndryshme administrative.	(13 – 25) mm	5.00
	32 mm	
	40 mm	
	50 mm	
	65 mm	
	80 mm	
	100 mm	
	150 mm	
2.2. Shpenzimet e Kyçjes në Shërbime të Ujësllësit*	Diametri i gypit të kyçjes/ujëmatësit	Shuma (EURO)
Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve (*) - Shpenzimet e Kyçjes në Shërbime përfshijnë shpenzimet e punës dhe materialit në vijim: qafore, pajisjet për kyçje, gypat e kyçjes në gjatësi deri 15 metra, ujëmatësi me dy valvula,transporti etj. Punët tokësore dhe ato të betonit nuk janë të përfshira.	(13 – 20) mm	120.00
	(25 – 32) mm	160.00
	(40 – 50) mm	220.00
	> 50mm	Do të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.
2.3. Shpenzimet e Kyçjes në Shërbimet e Ujërave të ndotura *	Diametri i gypit të kyçjes	Shuma (EURO)
Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve (*) – Shpenzimet e Kyçjes në Shërbime përfshijnë shpenzimin e punës dhe të materialit në vijim: elementet fazonike për kyçje dhe gypit në gjatësi deri 15 metra. Punët tokësore dhe ato të betonit nuk janë të përfshira.	DN 110 mm	100.00
	DN 160 mm	120.00
	DN 200 mm	160.00
	> 200 mm	Do të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.

3. Tarifat për Shërbimet Tjera

Afati i Aplikueshmërisë: 1 Janar 2018 – 31 Dhjetor 2018

Lloji i Shërbimit	Shuma (EURO)
3.1. Dërgimi i njoftimit për ndërprerje i faturohet vetëm njëherë konsumatorit dhe atë pas dërgimit të njoftimit të dytë brenda vitit kalendarik, sipas Ligjit Nr. 05/L-042, Neni 28 dhe 29, si dhe rregullores së ARRÜ Nr. 03/2016, neni 30	3.00
3.2. Shkyçja e Shërbimeve të Ujësjetës	20.00
3.3. Rikçja e Shërbimeve të Ujësjetës	20.00
3.4. Riparimi i rrjedhjeve në objektin e Konsumatorit	Duhet të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën
3.5. Shitja e ujit me cisterna të ujit – transporti deri në 5 km	20.00 EURO/5m3
3.6. Kontrollimi i ujëmatësit – verifikimi i saktësisë	15.00